

KOMUNA E FUSHË KOSOVËS 2017: PROBLEMET KRYESORE DHE TRENDET BUXHETORE

Hyrje

Fushë Kosova që nga zgjedhjet e para lokale (tetor 2000) udhëhiqet nga Lidhja Demokratike e Kosovës. Kryetari aktual i komunës Burim Berisha po e përmbyll mandatin e tij të tretë. Berisha në zgjedhjet e kaluara ka fituar në raundin e parë duke marrë 9,382 vota apo 64%, kurse i dyti me i votuar ka qenë Naser Grajqevci nga Partia Demokratike e Kosovës me 3,112 vota.¹

Hulumtimet tregojnë se qytetarët e Kosovës kanë njohuri të mjaftueshme mbi ndarjen e kompetencave në mes të pushtetit qendror dhe lokal.² Mbi 94% e qytetarëve të Fushë Kosovës konsiderojnë se komuna mund t'i zgjidhë problemet me të cilat ballafaqohen ata.³ Sipas studimit të UNDP, 49% e qytetarëve në Fushë Kosovë janë shprehur të kënaqur me punën e Kryetarit të Komunës, përderisa vetëm 30% e qytetarëve kanë konsideruar se fondet publike në komunë menaxhohen siç duhet.⁴

Në prag të zgjedhjeve komunale 2013, Instituti GAP kishte identifikuar pesë problemet kryesore të Komunës së Fushë Kosovës. Ndër problemet më madhore kishin dalë të jenë: mungesa e ujit të pijes, problemet nga lumenjtë Sitnica, Prishtevka dhe Drenica, ndotja e ajrit, mungesa e

¹ Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Rezultatet për Kryetarë Komune 2013. Burimi: <http://bit.ly/1d30foS> (hapur më 18 qershor 2017)

² Instituti GAP, Adresimi i Përgjegjësishë: Njohuritë e qytetarëve me kompetencat e komunave. Maj 2017. Burimi: <http://bit.ly/2os7GPU>

³ UNDP, Mozaiku i Kosovës 2015, faqe 37. Burim: <http://bit.ly/2wkuTnr>

⁴ UNDP, Mozaiku i Kosovës 2015, faqe 91. Burim: <http://bit.ly/2wkuTnr>

çerdheve publike, mungesa e kanalizimeve, dhe mungesa e shkollës në fshatin Sllatinë e Vogël.⁵

Problemet aktuale të Komunës së Fushë Kosovës

Problemet nga lumenjtë Sitnica, Prishtevka dhe Drenica

Kontaminimi i lumenjve nga derdhja e kanalizimeve dhe hedhja e mbeturinave paraqet problem për qytetarët e kësaj komune. Ky problem daton edhe nga mandati i kaluar (para zgjedhjeve të nëntorit 2013). Territorin e Fushë Kosovës e përshkojnë lumenjtë Sitnica, Drenica dhe Prishtevka. Kundërmimi i erërave dhe përhapja e insekteve nga këta lumenj vështirëson jetën e përditshme të qytetarëve. Lumi Prishtevka ngjason në një deponi mbeturinash.⁶

Ndërtimet e larta pa kritere

Komuna e Fushë Kosovës, krahas asaj të Prishtinës, llogariten të kenë numrin më të madh të ndërtimeve të larta. Komuna e Fushë Kosovës arsyetohet se në të gjitha rastet ekzistojnë lejet përkatëse ndërtimore dhe se ndiqen standardet e ndërtimit. Por në asnjë rast nuk haset që respektohet kriteri i krijimit të hapësirave për parkingje, hapësira të gjelbëruara në afërsi të ndërtesave si dhe mungojnë këndet rekreative për fëmijë. Në pjesën më të madhe të lagjeve mungojnë edhe hapësirat që potencialisht do të mund të shfrytëzoheshin për ndërtimin e çerdheve ose shkollave për banorët e ndërtesave. Po ashtu nuk shihen se ekzistojnë as shkallët emergjente në rast të ndonjë fatkeqësie. Në Ligjin për Planifikim Hapësinor specifikohet që secili ndërtim duhet t'i respektojë mes tjerash edhe këto kritere: kërkesat minimale për vend parkingje, kushtet e qasjes adekuate në rrugë publike dhe infrastrukturë teknike, përçindja e sipërfaqes së përgjithshme e gjelbërimit, lartësia e lejuar në raport me largësinë nga kufiri i parcelës kadastrale përgjatë rrugës publike, etj.⁷

Mbingarkesa e shkollave me nxënës

Shkolla e mesme e ulët "Mihajll Grameno" dhe shkolla "Selman Riza" kanë nga 45 nxënës në klasa. Udhëzimi administrativ i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë me numër 22/2013 lejon deri në 35 nxënës më së shumti. Përveç kësaj, në shkollën "Selman Riza" mësimi mbahet në tri

⁵ Instituti GAP. Problemet Kryesore dhe trendet buxhetore të Komunës së Fushë Kosovës 2013. Burim: <http://bit.ly/2rUuOnS>

⁶ Problemet nëpër komuna janë identifikuar në bazë të intervistave të drejtpërdrejta me përfaqësues komunal, të partive politike, shoqërisë civile, mediave dhe njohëseve të qeverisjes lokale.

⁷ Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Ligji për Planifikim Hapësinor. Neni 21. Ligji Nr. 04/L-174. Qasur me datë 28.08.2017. Burim: <http://bit.ly/2vFA4NS>

ndërrime. Kjo gjendje nuk është më e mirë as në shkollat e tjera të këtij qyteti, veçmas në ato të mesme. Komuna ka pranuar ekzistimin e këtij problemi, por nuk ka dhënë ndonjë plan se si do ta adresojë zgjidhjen e këtij problemi.⁸

Mos funksionalizimi i ambulancave nëpër fshatra

Komuna e Fushë Kosovës përmes donatoreve ka arritur t'i ndërtojë objektet shëndetësore në Miradi e Epërme, Miradi e Poshtme, Vragoli, Henc, Harilaq, Sllatinë, Bardh i Vogël, Bardh i Madh dhe Grabovc, por këto objekte nuk janë bërë funksionale shkak i mungesës së stafit adekuat mjekësor. Mos funksionalizimi i tyre ka bërë që këto qendra (objekte) t'i nënshtrohen dëmtimeve dhe vjedhjeve.

Problemet në lagjet e komuniteteve pakicë

Lagjet që në Fushë Kosovë njihen si lagjja "02", "07", "028" dhe "029" ku jetojnë afro pesë mijë banorë që i takojnë komuniteteve pakicë në Kosovë, veçmas romë, përballen me probleme të ndryshme. Përfaqësuesit e kësaj zone thonë se problemet kryesore janë mungesa e çerdhes, mungesa e qendrës rinore, mungesa e ujit të pijes, mungesa e ndriçimit publik, mungesa e gjelbërimit dhe e hapësirave sportive dhe rekreative si dhe prezenca e madhe e mbeturinave dhe qeneve endacak.

Objektet banesore pa mirëmbajtje dhe pa infrastrukturë

Ndërtesat publike të cilat e përshkojnë hapësirën përreth qendrës së vjetër të qytetit nuk janë gëlqerosur. Në këto ndërtesa vërehet mungesa e dyerve të hyrjes, mungesa e dritareve nëpër korridoret e ndërtesës, mungesa e ndriçimit në korridoret e brendshme të ndërtesave, mungesa e ashensorëve, si dhe mungesa e aparateve për fikjen e zjarrit.

Mungesa e transparencës


Komuna e Fushë Kosovës është në mesin e komunave që fare pak ka të dhëna për punën e saj në faqen e saj zyrtare në internet. Mungojnë të dhënat buxhetore, vendimet e kryetarit, lejet e dhëna të ndërtimit, raportet e punës, procesverbalet nga mbledhjet e Kuvendit, e të dhëna të tjera.

Fushat që kërkojnë vëmendjen e komunës

Integrimi i komuniteteve

Komuna e Fushë Kosovës sipas regjistrimit të fundit të popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave është njëra ndër komunat e cila ka

⁸ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Udhezim Administrativ 22/2013. Ministria e Arsimit Shkences dhe Teknologjisë. Burimi: <http://bit.ly/2xtUrQe> (qasur më 28 gusht 2017).



përqindjen me të lartë të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian.⁹ Ky komunitet kryesisht nuk vijon shkollimin. Komuna duhet të shoh mundësitë e inkurajimit të këtij komuniteti për t'u kyçur në sistemin arsimor. Përveç kësaj komuna duhet të zhvillojë edhe programe të ndryshme trajnimi me qëllim të integritit të këtij komuniteti në jetën shoqërore dhe atë institucionale.

Aktivitetet kulturore

Komuna e Fushë Kosovës nuk ka arritur të fus në funksion teatrin e qytetit, ndonëse ekziston qendra e kulturës. Në kuadër të kësaj qendre mungojnë aktivitetet letrare ose artistike. Përveç kësaj, Fushë Kosova nuk ka galeri për ekspozita dhe muze të qytetit.


Trendet buxhetore të komunës

Komuna e Fushë Kosovës në vitin 2017 ka planifikuar 9.5 milionë euro buxhet.¹⁰ Përveç planifikimeve të rregullta, Komuna e Fushë Kosovës ka bartur edhe 1.6 milionë euro nga të hyrat vetanake të vitit të kaluar, ndërsa në vitin 2013 ishin bartur 566 mijë euro. Krahasuar me vitin 2013, Komuna e Fushë Kosovës ka pasur një rritje të buxhetit afro 3.1 milionë euro. Rritja e buxhetit është bërë kryesisht në kategorinë e pagave dhe investimeve kapitale. Në krahasim me vitin 2013, në vitin 2017 buxheti për paga është rritur për 1 milionë euro (apo 31%), kurse buxheti për investime kapitale është rritur për 1.8 milionë euro (apo 77%). Krahasuar me vitin 2013, numri i të punësuarve në Komunën e Fushë Kosovës është rritur për 36 persona në vitin 2016.

⁹ Agjencia e Statistikave të Kosovës. Popullsia sipas gjinisë, etnicitetit dhe vendbanimit. Fq 13. Qasur me 28.08.2017. Burim: <http://bit.ly/2nzioB0>


¹⁰ Shih për më shumë platformën buxhetore të Institutit GAP në <http://bit.ly/2rMELbD>

Figura nr.1: Buxheti i Komunës së Fushë Kosovës 2017




Nga buxheti total i komunës gjatë vitit 2017, 46 % e buxhetit është ndarë për paga dhe mëditje, 43% për investime kapitale dhe përqindje më të vogla janë ndarë për tri kategoritë tjera ekonomike.

Figura nr.2: Trendet buxhetore në Fushë Kosovë 2013-2017



Komuna e Fushë Kosovës gjatë vitit 2016 ka arkëtuar 2.4 milionë euro të hyra vetanake komunale. Në vitin 2016 Komuna e Fushë Kosovës ka realizuar afro 580 mijë euro më shumë të hyra vetanake se në vitin 2013.

Figura nr.3: Të hyrat vetanake në Komunën e Fushë Kosovës 2013-2016



Burimi: Zyra e Auditorit të Përgjithshëm

Rekomandime

Duke u bazuar në problemet kryesore, fushat të cilat kërkojnë vëmendjen e Komunës dhe trendet buxhetore, Instituti GAP rekomandon që qeverisja e komunës e dalë nga zgjedhjet lokale të 2017 të ndërmerr këto veprime:

- Komuna e Fushë Kosovës duhet të tregohet me transparente për punën esaj. Komuna duhet t'i publikojë rregullisht raportet financiare të shpenzimeve, procesverbalet e punimeve të Kuvendit Komunal, planet rregulluese, rregulloret e miratuara, vendimet e kryetarit, raportin e punës si dhe planin e prokurimit publik.
- Komuna e Fushë Kosovës duhet të ndalojë ndërtimet pa leje dhe pa kritere urbanistike.
- Komuna e Fushë Kosovës duhet të nis të ndërtojë kolektorë në shtretërit e lumenjve, veçmas në zonat urbane.
- Komuna e Fushë Kosovës duhet të nis ndërtimin e shkollave të reja me qëllim të mënjanimit të problemit të tanishëm me mbingarkesë të nxënësve.
- Komuna e Fushë Kosovës duhet të nis programe trajnimi në fusha të ndryshme për komunitetin romë dhe t'i intergrojë ata në sistemin arsimor.
- Komuna duhet të marr masa për menaxhim më të mirë të mbeturinave.

INSTITUTI GAP
GAP INSTITUTE



Instituti për Studime të Avancuara GAP është një Think-Tank i themeluar në tetor të 2007 në Kosovë. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheq profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institucione të ngjashme në shtetet perëndimore. Kjo gjithashtu u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të mbush zbrazëtitë në mes të qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të mbushë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.

Ky projekt mbështetet nga:



**National Endowment
for Democracy**

Supporting freedom around the world